



TURGUT ÖZAL



EDITORIAL

Klubi i Medias

Drejtorë
Gleris Bekteshi
Ahmet Ercanli

Kryeredaktore
Imelda Prençe

Redaktorë
Erjona Saqe
Elda Rrustemi
Afërdita Bara
Ardiana Sallaku

Nxënës
Enia Xhaferraj
Sidrit Rrustemi
Rea Manoku
Daris Naska
Ester Mema
Ketlin Marku
Ami Hoxha
Andrea Bylykbashi
Alenis Ivanaj
Suada Xholi
Amisa Lesha
Keti Bardhoshi

Fotograf
Lulëzim Marra

Design:
Dorjan Pitani

ADRESA
Rruga "Bernardin Palja"
Ndërtesa 15, Hyrja 1
Njësia Bashkiake Nr.6
Tiranë – Shqipëri

TEL: +355 42 486-666
FAX: +355 42 486-666
info@turgutozal.edu.al

Misioni i një shkolle është edukimi dhe formimi i nxënësve të saj për t'i bërë ata qytetarë të denjë të vendit dhe të botës.

Të mësuarit ose të nxënët, pa dyshim që është parësori në këtë mision, por për të qenë një qytetar i denjë nuk mjaftojnë vetëm dijet, ndaj shkolla jonë synon të zhvillojë te nxënësit aftësitë e pjesëmarrjes qytetare dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.

Ky buletin pasqyron aktivitetet dhe veprimtaritë e zhvilluara gjatë periudhës së parë të vitit shkollor 2019-2020.

Edhe pse kanë qenë muaj të ngarkuar me ngjarje të pazakonta për vendin tonë, fotot dhe shkrimet në këtë buletin na tregojnë se fëmijët janë ata që i japin shtysë shoqërisë për t'u ringritur pas çdo stuhie.

Programet festive, vizitat nëpër institucione, olimpiadat, konkurset kombëtare e ndërkombëtare, udhëtimet brenda e jashtë vendit, klubet sipas prirjeve të nxënësve, veprimtaritë për javët e ndryshme shkollore, veprimtaritë humanitare të klubit "Shpresa", si dhe shumë aktivitete të tjera, kanë marrë hapësirën e tyre në këtë buletin.

Aktivitetet e zhvilluara janë vërtet të shumta, por, mbi të gjitha, ato janë plotësim i kërkesave për të pasur një brez nxënësish të ditur dhe të mbrujtur me të gjitha cilësitë që kërkon shekulli i XXI.



Shumë suksese në vitin e ri shkollor 2019-2020

Muaji i Letërsisë dhe i Arteve

Vizita në Institucione

Aktivitete të Klubit Shpresa

Konkurse dhe olimpiada

Takime dhe biseda

Mësojmë përmes praktikës

Aktivitete dhe veprimtari të tjera zbavitëse

Aktivitete sportive

Ekskursionë

Veprimtaritë e kopshtit





Shumë suksese në vitin e ri shkollor 2019-2020

Dita e parë e shkollës erdhi plot energji dhe entuziazëm, ashtu si nxënësit tanë dinë të jenë, në ambientet e kolegjit "Turgut Özal".

Në këtë fillim shtatori, në bankat e shkollës "Turgut Özal" u ulën rreth 1633 nxënës, nga klasa e 1-rë deri në klasën e 9-të.

Oborret, korridoret, klasat dhe ambientet e ndryshme të shkollës u gjallëruan nga zërat e nxënësve, të cilët përshëndeteshin plot mall me njëri-tjetrin dhe mësuesit, mes buzëqeshjeve, përqafimeve, buqetave me lule dhe dëshirës për arritje e rezultate sa më të larta në mësim.

U urojmë shumë suksese dhe rezultate sa më të larta nxënësve tanë gjatë këtij viti shkollor!



Fëmijët e klasave të para në Kolegjin “Turgut Özal”

Në Kolegjin “Turgut Özal”, dita e parë e shkollës solli urime dhe emocione të shumta për 168 nxënësit e klasave të para që nisën rrugën e dijes. Klasat dhe mjediset e ndryshme të shkollës ishin zbukuruar për t’i pritur këta fëmijë mes ngjyrave, buzëqeshjeve dhe urimeve. Emocione viheshin re edhe te prindërit dhe te të afërmit e fëmijëve, që nëpërmjet fotografive të shumta, i fiksonin me kënaqësi këto çaste të paharrueshme për fëmijët e tyre.





Praktikojmë përmes IXL



Si një shkollë që e ka përkrahur inovacionin dhe është përpjekur të jetë gjithmonë në hapin e duhur me teknologjinë, shkolla fillore "Turgut Özal", këtë vit ka lidhur kontratë me faqen IXL, faqja më e populluar online në botë.

IXL është një program gjithëpërfshirës i të mësuarit që ofron praktikë të pakufizuar në lëndët anglisht dhe matematikë, - programe të cilat janë të përafërta me programin kombëtar. Për këtë vit shkollor, po punojnë nxënësit e klasave të treta, të katërta dhe të pesta të ciklit fillor.

Një aspekt tjetër i veçantë i këtij programi është që fëmijët mund ta përdorin atë edhe nga shtëpia, kështu që edhe prindërit kanë mundësi për të ndjekur përparimin e fëmijëve të tyre.

Me krenari mund të themi se nxënësit tanë kanë thyer çdo rekord pyetjesh të vendosur nga IXL, duke arritur në praktikimin e mbi 1,000,000 pyetjeve në faqen online.

Urojmë sa më shumë praktikë dhe argëtim për nxënësit!



Aktivitetet e Muajit të Letërsisë dhe të Artit

“Themelin e diturisë dhe të atdhetarisë e përbën gjuha shqipe.” Tetori, Muaji i Letërsisë dhe Arteve, hap si çdo vit siparin e aktiviteteve artistiko-kulturore në kolegjin “Turgut Özal”, duke filluar kështu një maratonë aktiviteteve dhe konkurseve. Konkursi i Fjalës Artistike, Krijimit, Këngës dhe Artit figurativ, janë nga veprimtaritë më të dashura për nxënësit, ku ata shprehin botën e tyre të brendshme dhe iu jepet mundësia të shpalosin aftësitë dhe talentin e tyre.

Nuk mungojnë as projektet, përmes të cilave, nxënësit shfaqin aftësitë në artin e bukur të fjalës dhe tregojnë njohuritë e tyre letrare e gjuhësore.

Është krijuar një traditë e bukur kjo në shkollën tonë, traditë të cilën brezat e ardhshëm do ta pasurojnë e do ta zhvillojnë më tej.





Konkursi i Kompozicionit



Fjala e bukur, krijon veprën e bukur ...

"Gjuha është pasqyra më e qartë e një kombi dhe e kulturës së tij." - Eqrem Çabej

Letërsia është arti i të shprehurit dhe me fillimin e Muajit të Artit dhe të Letërsisë, ndër aktivitetet më të dashura që organizohen gjatë këtij muaji, është dhe Konkursi i Krijimit, ku nxënësve iu jepet mundësia të shprehin mendimet dhe idetë e tyre në formë eseje, lidhur me një temë të dhënë. Konkursi solli shumë entuziazëm mes shkrimtarëve tanë të vegjël. Tematikat kryesore ishin temat rreth dashurisë për atdheun dhe gjuhën tonë të bukur shqipe, por dhe tema që kanë të bëjnë me ëndrrat dhe dëshirat e fëmijëve.

Krijuesit më të talentuar dhe krijimet më të bukura do të kalojnë në fazën finale midis kolegjeve.

Konkursi i Interpretimit



Poezia, Arti i shprehjes së ndjenjave dhe i përjetimeve përmes bukurisë së fjalës, një trazim i brendshëm, herë-herë disi i pakuptueshëm, në vargje të lexueshme e plot emocione.

Konkursi i Interpretimit dhuroi emocione të veçanta tek juria e spektatorët përmes interpretimeve shumë të arrira të interpretuesve pjesëmarrës.

Larmishmëria e poezive dhe poemave nga autorë të njohur të letërsisë sonë, kishte si tematikë kryesore atdheun dhe dashurinë që e lidh çdo njeri me të. Nxënësit e përzgjedhur ishin mjaft të talentuar dhe ditën të përcjellin bukur mesazhet e teksteve që recituan.



Konkursi i Këngës



Muzika është gjuha e shpirtit përmes tingujve, shprehja më e bukur e emocioneve tona. Mes kësaj atmosfere plot ndjenja e emocione u zhvillua dhe Konkursi i Këngës. Me zërat e tyre të ëmbël, të fuqishëm e melodioz, finalistët dhe të gjithë nxënësit konkurrues, sollën në skenë këngë nga më të bukurat dhe që kanë mbetur e jetojnë te secili prej nesh.

Konkursi i Artit Pamor



Arti na tregon se bota nuk është bardhë e zi, përkundrazi është plot me ngjyra dhe përmes ngjyrave, secili shpreh botën, mendimet dhe ndjenjat e tij.

Në Konkursin e Artit Pamor nxënësit që morën pjesë, patën mundësinë për të shprehur ndjenjat e talentin e tyre nëpërmjet një gjuhe kaq të bukur siç është arti i ngjyrave. Temat e përzgjedhura ishin mjaft të njohura dhe të realizueshme nga ana e fëmijëve, duke përfshirë këtu "Natyra e Qetë", "Mbrotjtja e Mjedisit", "Përmes ëndrrës" dhe temat e lira, të cilat krijojnë hapësirën e duhur që nxënësi të shprehë imagjinatën, duke ndërthurur e përcjellë elemente edukative në formën e vijave, ngjyrave dhe figurave plot gjallëri, plot jetë dhe sinqeritet shprehës. Secila prej pikturave është si një e ujëvarë nga e cila derdhet bota e tyre.



Muaji i Historisë



Muaji nëntor vjen me dy datat e shënuara dhe ambientet e shkollës u veshën me ngjyrat kuq e zi. Emocioni, vëmendja dhe dashuria për atdheun, si dhe Festat e 28 dhe 29 Nëntorit ishin kryefjala e aktiviteteve të këtij muaji. U ekspozuan projekte e postera të ndryshëm dhe u zbukurua çdo ambient i shkollës me shqiponja dykrenare e flamuj të kuq. E veçantë ishte dhe ekspozita e hapur me objekte të ndryshme historike.

Për Ty Atdhe



Atdheu ynë, Shqipëria, flamuri ynë, nuk meritojnë vetëm një datë e një ditë, por çdo ditë është e denjë për t'i nderuar!

Poezitë dhe këngët kushtuar Flamurit e Atdheut, vallet plot ngjyra e të interpretuara me aq bukuri e elegancë, sajë talentit dhe përkushtimit të nxënësve tanë, emocionuan të gjithë të pranishmit në koncertin kushtuar atdheut tonë, Shqipërisë.





Në Gjykatën e Apelit

Nxënësit e klasës së 7B të kolegjit “Turgut Özal” vizituan Gjykatën e Apelit në Tiranë. Vizita në ambientet e këtij institucioni u mundësua nga një ftesë e bërë prej zotit Astrit Haxhialushi, i cili është gjykatës në këtë institucion. Nxënësit u njohën me ambientet kryesore dhe funksionet e kësaj gjykate. Më pas u improvizua një seancë gjyqësore, përmes së cilës nxënësit mësuuan se si është i formuar trupi gjykues dhe se si zhvillohet një proces gjyqësor. Kjo vizitë la mbresa te nxënësit, pasi iu zgjeroi njohuritë për këtë fushë



Në Muzeun e Shkencave të Natyrës “Sabiha Kasimati”

Nxënësit e klasës së 9A zhvilluan një vizitë në Muzeun e Shkencave të Natyrës “Sabiha Kasimati” në Tiranë. Ata vizituan të gjitha pavionet e muzeut, në të cilat tregohej evolucioni i botës së gjallë. Me kuriozitet ata panë speciet e ekspozuara, mbi 3000 eksponentë vendas dhe të huaj, përfshirë këtu faunën tokësore, detare, lumore, guackat dhe koralet. Nxënësit u njohën me një shumëllojshmëri gjallesash, por ata veçuan një çift pelikanësh kaçurrel, të cilët janë shumë të rrallë dhe të vështirë për t'u gjetur.





TOC TALKS



TOC Talks është nismë e kolegjit “Turgut Özal” për të nxitur nxënësit e tij të shprehin mendimin e tyre në lidhje me një temë që ata e shohin si të rëndësishme.

Nxënësit e të gjithë klasave mund të marrin pjesë dhe të sjellin argumentet e tyre para dëgjuesve. Fakti më interesant është se nxënësit mund ta zgjedhin vetë se kush do të jetë publiku i tyre. Këta mund të jenë shokët e shoqet e klasës, bashkëmoshatarë nga klasat e tjera si dhe më të mëdhenj në moshë se ta. Madje nxënësit mund të zgjedhin që të trajtojnë një temë edhe përpara stafit drejtues të shkollës ose vetë prindërve të tyre.

Është shumë e rëndësishme që fëmijët të mësojnë që në moshë të vogël që t'i shohin marrëdhëniet shoqërore nga këndvështrime të ndryshme dhe të arrijnë të formulojnë mendimin e tyre të cilin e mbrojnë duke sjellë argumente të ndryshme. Për këtë arsye shumë mësues të kolegjit i janë përkushtuar nismës TOC Talks dhe nxisin nxënësit të marrin pjesë në të.



Si të veprojmë në rast tërmeti

Një ndër aktivitetet e zhvilluara për mbrojtjen e sigurinë e nxënësve tanë ishin aktivitetet ndërgjegjësuere “Si të veprojmë në rast tërmeti”, të cilat u zhvilluan në çdo klasë. Nga tabelat Interaktive u bë e mundur shfaqja e një videoje ndërgjegjësuere për reagimin që duhet të kenë fëmijët në raste emergjente si tërmeti. Më pas, u diskutua rreth videos dhe veprimet që duhet të kryhen gjatë kohës që lëkundjet vazhdojnë. Në fund, u kalua në veprime konkrete me improvizim situatash pas lëkundjeve dhe dhënie të alarmit për të dalë nga klasat.



SEPSE SHPRESË E KA EMRIN...



Klubi SHPRESA është një nga klubet më aktive dhe më të dashura për nxënësit, i cili jo vetëm nxjerr në pah ndjeshmërinë dhe humanizmin për njerëzit që vuajnë e janë në nevojë, por forcon tek ata dhe ndjenjën e përgjegjshmërisë për të ndihmuar në krijimin e një bote më të mirë e humane...



Seminari i parë i Klubit Shpresa për vitin shkollor 2019-2020



Të kontribuosh në bamirësi dhe të ndihmosh të tjerët, është tashmë një traditë e bukur dhe shumë e dashur në shkollën tonë, është një prej vlerave që na përfaqëson. Në seminarin e parë të Klubit Shpresa, nxënësit u njohën me objektivat e synuara për këtë vit, ndër të cilat përmenden ndihmat e planifikuara në 3 shkolla dhe 2 kopshte publike, në Shoqatën e Jetimëve, në Shoqatën e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara, aktivitet në bashkëpunim me organizatën joftimprurëse DSA, mbledhje ndihmash në ushqime në bashkëpunim me Foodbank Albania dhe aktivitete të planifikuara për "Fundjavë ndryshe"

"Dashuria dhe mirësia nuk shkojnë kurrë dëm. Ato gjithmonë bëjnë diferencën. Lumturojnë atë që i merr dhe të lumturojnë edhe ty, që i jep". - Barbara de Anxhelis



Panairi i Ushqimeve

Të ndihmojmë në krijimin e një bote më të mirë dhe me më pak varfëri dhe vuajtje.

Panairi i Ushqimeve është një nga aktivitetet më humane, i zhvilluar nga përfaqësuesit e Klubit "Shpresa" në bashkëpunim me Drejtorinë e kolegjit "Turgut Özal", me qëllimin madhor: Krijimin e një bote më të mirë e me më pak varfëri dhe vuajtje.

Ky aktivitet i përvitshëm, ka si synim ndërgjegjësimin e të gjithë nxënësve se: "Të ndihmosh dhe të sjellësh sadopak ndryshim në jetën e dikujt, fal lumturi e shpresë. Të dhurosh, të jep më shumë kënaqësi se të marrësh!"

Ky organizim kërkon aktivizimin vullnetar të të gjithë nxënësve për grumbullimin e sa më shumë të ardhurave me anë të shitjeve të produkteve të ndryshme ushqimore, në mënyrë që t'u vijë në ndihmë njerëzve në nevojë.

Mbyllja më e bukur e Panairit Ushqimor

Ëmbëlsia dhe shija e Panairit Ushqimor ishte shumë e veçantë, sidomos gjatë ditëve të panairit me vogëlushët e kopshtit. Diku si flutura të bukura e diku si bletë punëtoresh, të veshur si mastershefa të vërtetë kuzhine, këta fëmijë gjallëruan ambientet e sallës së panaireve. Ëmbëlsia e ushqimeve dhe ëmbëlsia e fëmijëve krijojnë një atmosferë sa të gëzueshme, aq dhe festive, mes tingujve të muzikës dhe zërave gazmorë e të qeshurave fëmijore. Janë kaq të bukura aktivitete të tilla, ku mbizotëron kënaqësia, lumturia dhe dashuria për njëri – tjetrin. Ky panair u mbyll me sukses të plotë, pikërisht me panairt e më të vegjëlve.





Së bashku bëhemi më të fortë!

Klubi Shpresa, duke u solidarizuar me banorët e prekur nga tërmeti i 26 nëntorit, dërgoi ndihmat e para (batanije) në Thumanë dhe asistoi duke parë nga afër gjendjen emergjente në të cilën ndodhen banorët e kësaj zone. Të gjithë bashkë në këto ditë të vështira!



1 Klubi Shpresa vazhdon të ndihmojë njerëzit në nevojë dhe këtë periudhë aktivitetet e Klubit Shpresa kanë qenë në ndihmë të të dëmtuarve nga tërmeti i 26 nëntorit.

2 Gjatë ditëve të fundit nga Klubi Shpresa në bashkëpunim me Drejtorinë e Kolegjit "Turgut Özal", janë shpërndarë për të dëmtuarit në zonën e Thumanës dhe në Vorë 200 batanije dhe veshmbathje për 400 persona..

3 I është dhuruar një karrocë për personat me aftësi të kufizuar një banoreje, e cila ishte dëmtuar nga tërmeti, në Pezë Helmës. Gjithashtu është riparuar çatia e dëmtuar e një shtëpie.

4 Janë shpërndarë 750 racione ushqimore (në bashkëpunim me Bereqet Catering), në Krujë. Ushqimet janë shpërndarë në 3 vakte të ndryshme (2 dreka dhe 1 vakt në darkë).

Klubi Shpresa do vazhdojë misionin e tij duke kontribuar në ndihmë të njerëzve në nevojë. Faleminderit të gjithëve për mbështetjen që na jepni!

Mjete shkollore dhe lodra për shkollën “Katund i ri”



Ishin nxënësit e klasave të nënta, anëtarë të Klubit Shpresa, të cilët dhuruan ndihma në mjete mësimore për kopshtet në shkollën “Katund i ri”, gjithashtu pasuruan bibliotekën e shkollës me libra jashtëshkollore për bashkëmoshatarët e tyre në këtë shkollë.

Për 65 fëmijët e kopshtit, i cili ndodhej brenda godinës së shkollës, dhe një kopshti vartës, ishin përgatitur pako me mjetet më të nevojshme mësimore dhe lodra. Edhe në këtë aktivitet nuk munguan këngët e recitimet mes fëmijëve, të cilët me çiltërsinë dhe mirësinë që i karakterizon, arrijnë të shpalosin talentin e tyre kudo.

Mes kënaqësisë, fotove dhe buzëqeshjeve, vogëlushët shijuan vërtet momente të paharrueshme që i fal vetëm mirësia dhe humanizmi.



Ndihma për familjet e strehuara në hotel “Bonita”

Klubi Shpresa dhe nxënësit e klasave të 6-ta të kolegjit “Turgut Özal” dhurojnë ndihma në ushqime, ujë, detergjent, letra higjienike, lodra për fëmijë, batanije e veshmbathje, për personat e prekur nga tërmeti, të cilët janë akomoduar në hotel “Bonita”, Golem. Lodrat iu shpërndanë vetë fëmijëve dhe prindërve të tyre, ndërsa ndihmat e tjera iu dorëzuan menaxheres së hotelit për t’ua shpërndarë secilit prej banorëve të strehuar aty.

Ndihma për 10 familje të prekura nga tërmeti në Vorë

“Së bashku jemi më të fortë!”

Thirrjes së solidaritetit të Klubit Shpresa për të ndihmuar familjet e prekura nga tërmeti, nxënësit e shkollës sonë iu përgjigjën me devotshmërinë që i karakterizon gjithmonë për të ndihmuar familjet e njerëzit në nevojë. Një nga këto aktivitete të Klubit Shpresa me nxënësit e klasave të 5-ta, ishte shpërndarja e disa prej ndihmave në ushqime, lodra për fëmijë, batanije e veshmbathje për 10 familje të prekura nga tërmeti në Vorë.

Klubi Shpresa falënderon të gjithë nxënësit e shkollës sonë dhe prindërit e tyre për mbështetjen që na japin gjithmonë në realizimin e misionit tonë humanitar.



Ndihma për 5 familje në fshatin Ndroq

Me dëshirën për të dhënë kontributin e tyre për të ndihmuar sadopak familjet e prekura nga tërmeti, nxënësit e klasës së 7D mblodhën ndihma ushqimore dhe detergjent, të cilat iu shpërndanë 5 familjeve në fshatin Ndroq.

Nxënësit u prekën shumë nga gjendja e vështirë e këtyre familjeve, por dhe ndjenë kënaqësinë që të fal bamirësia dhe humanizmi. Aktivitetet bamirëse në këto ditë të fundit të vitit, nga nxënësit e shkollës sonë kanë qenë të shumta.



Ndihmojmë tre familje në fshatin Ndroq

Afrimi i festave të fundvitit na bën më të ndjeshëm ndaj njerëzve në nevojë, rrit te ne dhe dëshirën për të bërë dhurata e bamirësi. Dhe nxënësit e klasës së 7G me dëshirën për të bërë dikë të lumtur, mblodhën ndihma ushqimore dhe ia dhuruan ato tre familjeve të prekura nga tërmeti në fshatin Ndroq.



Ndihma për familjen në Maminas

Nxënësit e klasës së 7B në prag të festave të fundvitit vijuan nismën e nisur një vit më parë “Të bëjmë një familje të lumtur në prag festash”. Nxënësit, së bashku me mësuesen kujdestare, mbledhën ndihma në ushqime dhe mjete monetare dhe ia dhuruan ato një familjeje në vështirësi ekonomike në fshatin Maminas. Ky është i dyti vit që kjo klasë ndihmon këtë familje me 6 fëmijë të mitur dhe me një histori shumë të dhimbshme familjare. Nxënësit dhuruan ushqime, veshje dhe një sasi prej 200 mijë lekë të vjetra.



Ndihmë për nxënësit e prekur nga tërmeti, në Pezë të Madhe

Anëtarët e klasave të teta të Klubit Shpresa, dhuruan mjete mësimore për 100 nxënësit e shkollës në Pezë të Madhe dhe shkollës vartëse të Pajanës. Shkolla “16 Shtatori” u dëmtua rëndë nga tërmeti dhe nxënësit e kolegjit “Turgut Özal” u dhuruan bashkëmoshatarëve të tyre pako me mjete mësimore. Për Klubin e Sportit u dhuruan topa futbollit, basketbolli dhe volejbollit. Një ndihmë tjetër ishte edhe një sasi e konsiderueshme librash, dhuratë për bibliotekën e shkollës. Çdo ndihmë u prit me gëzim dhe buzëqeshja në fytyrat e nxënësve dhe mësuesve na bënë të ndiejmë se vullnetarizmi dhe bamirësia janë vlera që çmohen e nuk humbasin kurrë.





Klubi Shpresa mundëson terapinë e dy fëmijëve në Qendrën e Shërbimeve PRO PAK

Nxënës të klasave të teta, anëtarë të të Klubit Shpresa dhe Ndërgjegjësimi, zhvilluan një aktivitet bamirësie në Qendrën e Shërbimeve PRO PAK. Qëllimi i këtij aktiviteti nga Klubi Shpresa, në bashkëpunim me drejtorinë e kolegjit "Turgut Özal", ishte mundësimi i seancave terapeutike për dy muaj, të dy fëmijëve me Sindromën Down, të cilët marrin shërbime pranë kësaj qendre.





SUKSESET E NXËNËSVE TANË NË OLIMPIADA



Nxënësit tanë janë krenaria jonë! Nga datat 17-20 qershor u zhvillua në Cambridge University, Konkursi Ndërkombëtar “The Intellectuals’ Challenge”, në të cilin kolegji “Turgut Özal” u përfaqësua nga 11 nxënës të klasave të 7-ta dhe të 8-ta. Të gjithë nxënësit pjesëmarrës shkëlqyen në Owlypia – The Intellectuals’ Challenge, duke fituar këto medalje:

Andrea Bylykbashi – 3 Medalje ari, 1 Medalje argjendi dhe 1 Medalje bronzi
 Martina Gjoni – 2 Medalje ari, 2 Medalje argjendi dhe 1 Medalje bronzi
 Anda Bushi – 2 Medalje ari dhe 2 Medalje bronzi
 Keti Bardhoshi – 1 Medalje ari, 1 Medalje argjendi dhe 2 Medalje bronzi
 Enxhi Mustafaj – 1 Medalje ari, 1 Medalje argjendi dhe 1 Medalje bronzi
 Ana Kendella – 1 Medalje ari, 1 Medalje argjendi dhe 1 Medalje bronzi
 Enia Xhaferraj – 3 Medalje ari, 1 Medalje argjendi dhe 1 Medalje bronzi
 Brendis Kasharaj – 2 Medalje ari, 1 Medalje argjendi dhe 2 Medalje bronzi
 Kiara Olldashi – 2 Medalje ari dhe 1 Medalje bronzi
 Boris Metaliaj – 1 Medalje ari, 1 Medalje argjendi dhe 2 Medalje bronzi
 Buen Hoxha – 1 Medalje ari, 3 Medalje bronzi



Këta nxënës u paraqitën në këtë konkurs pas pjesëmarrjes së suksesshme në Owlypia Online dhe Owlypia Local, e cila u zhvillua në Shqipëri në muajin mars.



**Nxënësit
e kolegjit "Turgut
Ozal" vlerësohen me medalje
në Genius Olimpiad**



Shkolla jonë me nxënësit e saj përfaqëson suksesshëm Shqipërinë për të disatin vit radhazi në Olimpiada Ndërkombëtare.

Këtë vit, një grup nxënësish finalistë morën pjesë në Olimpiadën GENIUS, organizuar në Oswego, New York, SHBA.

Nxënësit Aurel Domi, Brendon Janku dhe Martin Lipe fituan medalje argjendi me projektin e tyre në Konkursin e Robotikës. Ata konkurruan me një robot në formë krah, të ndërtuar duke përdorur Lego.

Dea Merkaj, nxënëse e klasës së shtatë, e fitoi medaljen e argjendtë në Konkursin e Këngës, kategoria muzikë.



Testi përzgjedhës për Olimpiadën Cogito

U zhvillua në datën 12 tetor në ambientet e kolegjit "Turgut Özal" testi përzgjedhës i Olimpiadës COGITO, për klasat 6-9, në lëndët: Matematikë, Fizikë, Kimi dhe Biologji.

Në provim morën pjesë 200 nxënës, nga të cilët do të përzgjidhen 6 nxënës për çdo paralel, në secilën prej lëndëve. Këta nxënës, të cilët do të përfaqësojnë shkollën tonë në provimin final, në datën 15 Maj 2020.



Përgatitje për Provimet e Lirimit

Në shkollën tonë i kushtohet rëndësi e veçantë përgatitjes për provimet në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Për arritje sa më të larta në provimet kombëtare, nxënësit e klasave të nënta zhvillojnë orë përgatitore në lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe anglisht. Gjithashtu zhvillohen dhe modele provimesh lirimi në këto lëndë. Këto provime përgatitore do të ndihmojnë nxënësit tanë të kenë rezultate sa më të larta në Provimet e Lirimit.



Ceremonia e ndarjes së çmimeve në Finalen e Madhe midis Kolegjeve

Zhvillimi i fazës finale të Konkurseve të Këngës, Krijimit, Interpretimit dhe Artit pamor dhe Ceremonia e ndarjes së çmimeve për këto konkurse, është iniciativë e shkëlqyer që është bërë traditë tashmë në shkollat tona dhe është tregues i punës që ne bëjmë si shkollë për talentet dhe brezin e ri. Ne jemi të bindur që nxënësit e talentuar duhen mbështetur, duke u motivuar në mënyrat e duhura me të gjitha mundësitë dhe potencialet ndihmëse që mund t'u ofrojë shkolla e më gjerë.

Fushat e konkurrimit që përfshihen në këto konkurse janë: Arti Pamor, Kënga, Interpretimi dhe Krijimi.

Në juri ishin sërish emra nga më të njohurit në fushën e këngës dhe artit shqiptar, të cilët vlerësuan talentin dhe punën e bërë nga nxënësit dhe mësuesit që i kanë drejtuar.



Testim online përmes programit AMC (Konkursi Amerikan i Matematikës)



Nxënësi Amir Gjana fiton medaljen e argjendtë në konkursin ndërkombëtar të matematikës AMC. Në këtë provim morën pjesë nxënës të klasave të shtata dhe të teta të kolegjit "Turgut Özal", të cilët kanë testuar online, njohuritë e tyre në lëndën e matematikës përmes programit AMC (American Mathematics Competitions). AMC është një provim 40 minuta, me 25 pyetje me alternativa dhe zhvillohet online. Ky provim, porsë vetë programi AMC, tenton nxitjen e aftësive matematikore të nxënësve që marrin pjesë dhe i aftëson nxënësit në njohuritë e fituara në klasë dhe më tej për të zgjidhur problema unike. Ky program ndihmon në zbulimin e nxënësve të talentuar në matematikë dhe ndikon pozitivisht në aftësitë analitike të nevojshme për një shoqëri inovative. Nxënësit pjesëmarrës u vlerësuan me certifikatë.



Vendi i dytë në Olimpiadën Ndërkombëtare të Turqishtes

Në Olimpiadën Ndërkombëtare të Gjuhës turke (Turkçe Olimpiyatlar), organizuar nga IFLC, zhvilluar në muajin maj 2019, nxënësja e klasës së tetë Onejda Sheshori, ka fituar vendin e dytë në botë, duke u vlerësuar me medalje dhe vlerësimet përkatëse si pjesë e çmimit.

Kjo olimpiadë zhvillohet në dy faza. Në fazën e parë konkurruesit u testuan në një provim prej 100 pyetjesh në lidhje me njohuri të përgjithshme në gjuhën turke.

Në fazën e dytë konkurruesit u testuan në njohuri gjuhësore dhe krijimtari letrare.


Përgëzojmë për fitoren në këtë olimpiadë nxënësit pjesëmarrës, fituesit dhe mësuesit përkatës.

Faza e parë dhe e dytë e Olimpiadës Kombëtare të Matematikës

Nxënësit e shkollës sonë gjithmonë na nderojnë dhe arrijnë rezultate shumë të larta në olimpiada e konkurse kombëtare e ndërkombëtare, në të cilat ata marrin pjesë.

Gjatë muajit janar u zhvillua faza e parë dhe e dytë e Olimpiadës Kombëtare të Matematikës. Kjo fazë u zhvillua në ambientet e kolegjit "Turgut Özal" dhe morën pjesë 35 nxënës të klasave të nënta.

Nga këta 7 nxënës kaluan në fazën e dytë dhe përfaqësuan shkollën tonë në këtë olimpiadë. Faza e dytë u zhvillua në shkollën "Qemal Stafa" dhe nxënësja e klasave të 9-ta, Amelia Duxha u kualifikua në fazën finale të Olimpiadës Kombëtare të Matematikës.



Përfaqësohemi denjësisht në Olimpiadën "ChemiCo"


Në çdo konkurs kombëtar e ndërkombëtar nxënësit tanë korrin veç fitore. Në konkursin e 6-të ndërkombëtar të kimisë "ChemiCo" zhvilluar gjatë muajit Nëntor 2019 në Singapor, ku morën pjesë rreth 336 nxënës nga e gjithë bota, pati pjesëmarrës edhe nga shkolla jonë. Nxënësja e klasave të 9-ta të shkollës sonë, Anja Priftaj, fitoi Medalje Bronzi, ndërsa nxënësit Noel Huti e Brendon Janku u dalluan për certifikatat "Honourable Mention". Ky konkurs zhvillohet online, zgjat 90 minuta dhe ka pyetje me alternativa.

PËRGATITJA PËR OLIMPIADËN COGITO



Një nga qëllimet kryesore të shkollës sonë është edhe evidentimi i dhuntive dhe prirjeve të çdo nxënësi në fusha të caktuara.

Për një realizim sa më të suksesshëm të këtij qëllimi, në shkollën tonë organizohen olimpiada për lëndë të ndryshme. Këta nxënës konkurrojnë më pas në olimpiada kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas fushave përkatëse, por synimi kryesor është Olimpiada COGITO. Nxënësit dhe mësuesit e secilës lëndë kanë filluar parapërgatitjet mësimore të olimpiadave. Në to marrin pjesë nxënës nga klasa e 6-të deri në klasën e 9-të dhe janë afërsisht 100 nxënës, të cilët janë përzgjedhur në bazë të prirjeve dhe testimeve eliminuese. Lëndët e përfshira në këto olimpiada janë: matematikë, fizikë, biologji, kimi, informatikë, anglisht dhe turqisht. Parapërgatitjet zhvillohen nga mësuesit përkatës të lëndës.



Një bashkëbisedim me gazetaren dhe shkrimtaren Rudina Xhunga

“Shqipëria është një vend i mrekullueshëm dhe ka njerëz të mrekullueshëm. Atdheu është ai vend, të cilin njeriu nuk e gjen dot kund tjetër.”

Nxënësit e klasave të 9-ta, në vijim të aktiviteteve të Muajit të Artit dhe Letërsisë, në ambientet e bibliotekës së shkollës, zhvilluan një bashkëbisedim me gazetaren dhe shkrimtaren Rudina Xhunga. Tematika kryesore ishte mbi librin “Shkrimtarët e shekullit: 31 intervista në bibliotekën e botës”, por në këtë bashkëbisedim plot emocion, nuk munguan pyetjet e përgjigjet mbi gazetarinë, letërsinë, sfidat e ndryshme të jetës dhe letërsisë, rrugën drejt suksesit dhe rëndësinë e shkollës, si një pasaportë e sigurt për një të ardhme të suksesshme.

Gjithashtu, gjatë bashkëbisedimit, zonja Xhunga i këshilloi nxënësit që të mos e lëshojnë kurrë letërsinë, të shkojnë pas ëndërrave të tyre dhe të luftojnë për t'i realizuar ato, dhe të luftojnë që të gjejnë zërin e tyre në jetë.

Një regjisor dhe një shkrimtar mes nesh

Një bisedë e veçantë ishte edhe ajo që u organizua me regjisorin Kujtim Gjonaj dhe shkrimtarin për fëmijë Pandeli Koçi (i njohur me emrin letrar Sazan Goliku).

Të ftuarit u pritën nga nxënësit e klasës 4F, të cilët ishin veshur me kostume popullore nga të gjitha trevat e Shqipërisë. Me këto kostume ata treguan se arti dhe letërsia i kanë rrënjët në popull. Takimi u zhvillua më pas në sallën e vogël të shfaqjeve me nxënësit e klasave të 4D, 4E dhe 4F. Si shkrimtari, ashtu edhe regjisorin i njohur ndanë me fëmijët dashurinë për letërsinë, pasionin për filmin, si dhe mbresat e kujtimet e tyre nga hapat e parë të krijimtarisë.



Takimi me aktorin Arben Derhemi

Klasa e 4C pati mundësinë të zhvillonte një takim me aktorin e njohur Arben Derhemi. Të gjithë nxënësit ishin shumë të entuziazmuar për këtë vizitë të veçantë. Gjatë takimit fëmijët patën mundësi të bisedonin me aktorin për tema në lidhje me karrierën e tij, jetën e tij shkollore dikur, filmat, por edhe për jetën e tij të përditshme si prind. Aktori u tregoi fëmijëve për momente të veçanta që i kanë ndryshuar jetën, për filmin e tij të preferuar dhe për filmat ku atij i pëlqen të jetë protagonist. Mënyra e tij e çiltër e komunikimit, gjuha e thjeshtë dhe humori bënë që fëmijët ta ndiqnin me vëmendje e me kënaqësi gjithë bisedën me aktorin dhe, mbi të gjitha, u ndjenë shumë mirë për t'i drejtuar atij pyetjet që donin. Ai u tregoi se i pëlqen gatimi dhe në kohën e lirë gatuan me vajzën e tij që është nxënëse te kjo klasë. Në fund fëmijët bënë foto dhe morën autografe.



“Lufta kundër bullizmit” me Florian Binaj

Nxënësit e shkollës sonë, në vijim të projektit “Lufta kundër bullizmit”, zhvilluan një bashkëbisedim me aktorin e njohur Florian Binaj. Kjo bisedë u fokusua te fenomeni i bullizmit, ku nëpërmjet pyetjeve të ndryshme, aktori ndau eksperiencat e tij dhe, njëkohësisht, dha shumë mesazhe për nxënësit lidhur me vlerat e vërteta njerëzore që ata duhet të kultivojnë tek vetja. Është për t'u përgëzuar fakti që një aktor i humorit sjell me kaq seriozitet një shqetësim të rinisë së sotme siç është bullizmi. Falënderojmë aktorin Florian Binaj për energjinë pozitive dhe mesazhet që u dha nxënësve!



Me psikoterapisten Blerta Bodinaku



Nxënësit e klasave të 8-ta dhe 9-ta zhvilluan sot një bashkëbisedim me psikoterapisten Blerta Bodinaku. Bashkëbisedimi u fokusua më së shumti në temën "Rëndësia e shëndetit mendor".

Nxënësit me dëshirën dhe kuriozitetin për të ditur sa më shumë për këtë temë krijuan një atmosferë mjaft të ngrohtë dhe pozitive. Gjatë bisedës u shkëmbyen mjaft eksperiencë, të cilat nxënësit i gjetën tepër interesante.

Seminar me Dr. Valmora Gogo

"Komunikimi efektiv"

Një seminar me tematikë "Komunikimi efektiv" u zhvillua në formën e një bashkëbisedimi interaktiv me stafin ndihmës të shkollës sonë. Fokusi kryesor i këtij seminary ishte se si të bëhemi 'mjeshtër' të komunikimit për 21 ditë. Qëllimi i seminarit ishte që secili prej nesh me anë të disa teknikave mund të përmirësojë komunikimin në çdo lloj pozicioni pune ku mund të jetë. Ky seminar pati ndikim shumë pozitiv tek pjesëmarrësit, të cilët u ndjenë të përfshirë maksimalisht.



Me lektoren Erilda Ajazi

Në kuadër të aktiviteteve për bullizmin, në kolegjin "Turgut Özal", kishim të ftuar në një seminar lektoren Erilda Ajazi. Gjatë seminarit nxënësit u njohën me llojet e bullizmit, mënyrat e menaxhimit të rasteve të bullizmit dhe shumë elemente të tjera të rëndësishme. Nxënësit bashkëvepruan duke drejtuar pyetje të ndryshme, të cilat krijuan një atmosferë ndërgjegjëse dhe reflektimi.



Seminar me lektoren Jonida Tirana

Arritjet akademike të nxënësve, luajnë një rol të madh në vetëvlerësimin që ata kanë për veten. Ato formojnë të ardhmen e tyre dhe ndikojnë në pozitën e tyre të ardhshme në shoqëri. Vlerësimet dhe notat që ata marrin, ndikohen prej shumë faktorëve, prej të cilëve kryesorët janë koha e shpenzuar duke studiuar dhe mënyra si ata studiojnë.

Këto ishin disa prej tematikave të trajtuara në seminarin "Teknikat e të mësuarit" me lektoren Jonida Tirana, ku nxënësit u njohën me teknika të reja studimi, të cilat do t'i ndihmojnë ata në vazhdimësi.





Gëzuar Shqipëria ime!



Bashkëbisedim me profesoreshën e nderuar Luljeta Bozo

Profesoresha e nderuar Luljeta Bozo vizitoi nga afër institucionin tonë dhe, pasi shprehu admirimin e saj për strukturën e shkollës, zhvilloi një bashkëbisedim të vlefshëm me stafin pedagogjik dhe nxënësit tanë.

Në bashkëbisedimin e saj me stafin e me nxënësit, ajo u shpreh se u ndje e surprizuar nga kjo pritje kaq e ngrohtë dhe entuziaste dhe më pas, me një gjuhë të thjeshtë, të kujdesshme e të kuptueshme, trajtoi disa nga çështjet më të rëndësishme, të cilat janë kaq të prekshme sidomos në këto ditë.

Ky takim u zhvillua në vijueshmërinë e aktiviteteve informuese që bëhen në shkollën tonë dhe u dëgjua me shumë vëmendje e interes nga nxënësit e ftuar në këtë takim.



Seminar me Dr. Ana Uka

Zyra e Këshillimit të Karrierës gjatë këtij viti ka planifikuar organizimin e disa seminareve për prindërit në lidhje me edukimin. Seminari i parë u organizua në muajin nëntor dhe tematika ishte “Roli i prindërve në edukimin e fëmijës”. Ky seminar u mbajt nga Dr. Ana Uka. Seminari u zhvillua në formën e një bashkëbisedimi ku rol të rëndësishëm mori edhe pjesëmarrja e prindërve. Pikat kryesore që u diskutuan ishin:

1. Sfidat e prindërve në edukimin e fëmijëve në ditët e sotme
2. Menaxhimi i kohës së lirë me fëmijët.





Dita Evropiane e Gjuhëve



“Të mësosh një gjuhë tjetër, nuk është thjesht dhe vetëm të mësuarit e fjalëve të tjera për të njëjtat gjëra e realje, por të mësosh një mënyrë tjetër sesi të mendosh për gjërat.”

Me këtë lajtmotiv u organizuan aktivitetet për Ditën Evropiane të Gjuhëve në 26 shtator dhe në kolegjin “Turgut Özal”.

Aktivitetet e zhvilluara për këtë ditë ishin nga më të larmishmet, që nga posterat e projektet e ndryshme, interpretimet e poezive dhe dialogëve në gjuhë të ndryshme evropiane, deri te emocionet e veçanta që përcollën këngët e interpretuara me aq ndjenjë prej nxënësve të talentuar të shkollës sonë.

Qeveria e Nxënësve

Në fillim të muajit tetor, në ambientet e shkollës sonë, u zhvilluan zgjedhjet për Presidentin e Qeverisë së Nxënësve, e cila përfshin senatorët e zgjedhur nga klasat e 6-ta, të 7-ta, të 8-ta dhe të 9-ta. Kandidatët për Presidentin e shkollës ishin nxënës nga klasat e 9-ta dhe secili prej tyre prezantoi platformën, në të cilën do të fokusohesh puna e tij si president i Qeverisë së Nxënësve. Presidentja e zgjedhur, gjatë prezantimit të saj u shpreh se detyrë parësore si presidente e shkollës do të ishte rritja dhe kultivimi i ndjenjës së përgjegjësisë dhe bashkëpunimit të bashkëmoshatarët, dhënia e ndihmës së pakursyer ndaj shtresave në nevojë, motivimi i nxënësve për të mësuar, respektimi i rregullores së shkollës dhe vazhdimësia me angazhimin në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.

Si çdo vit, Qeveria e Nxënësve do të përfaqësojë dhe mbrojë interesat e të gjithë nxënësve të shkollës sonë.



Qeveria e Nxënësve nisma në mbrojtje të mjedisit



Një nga aktivitetet kryesore ku do të fokusohet veprimtaria e Senatit të shkollës për vitin shkollor 2019-2020, është ideja e mbrojtjes së mjedisit dhe se me aq sa kemi mundësi të veprojmë, se si mund ta ndalojmë ndotjen e mjedisit sadopak. U propozua të vihet në skenë një pjesë teatrale e krijuar nga vetë nxënësit, me temë mbrojtjen e mjedisit. Përmes saj nxënësit do të përcjellin ide e mesazhe, duke qenë vetë nxënësit skenaristë, aktorë e kostumografë. Kjo shfaqje do të vihet në skenën e shkollës sonë, por edhe në ambiente të tjera, pse jo dhe jashtë shkolle.

Biblioteka online “myOn”

Biblioteka online “myOn”, ka zgjeruar gamën e titujve që nxënësit tanë mund të lexojnë dhe është një hapësirë më shumë për të rritur dëshirën për të lexuar.

Kolegji “Turgut Özal” në bashkëpunim me bibliotekën online “myOn” ka pajisur të gjithë nxënësit, nga klasa e tretë e deri në klasën e nëntë, me një adresë personale përmes së cilës ata mund të lexojnë libra online. Biblioteka përmban mbi 5760 tituj dhe libra të fushave të ndryshme. Gjatë ditëve të shkollës nxënësit mund t’i lexojnë librat në orën e leximit, duke shkuar tek iPad room ose në laboratorët e kompjuterave. Niveli i lexueshmërisë (lexile level) është i matshëm, pasi për çdo javë sistemi gjeneron një raport përsa i përket faqeve të lexuara, kohës së shpenzuar në bibliotekë dhe nëse niveli i lexueshmërisë është rritur apo jo. Gjithashtu për çdo libër ka quize, përmes të cilëve çdo nxënës mat kuptueshmërinë ndaj librit të lexuar.



Unë lexoj...



Leximi i librit jashtëshkollor është një traditë e bukur prej shumë vitesh në kolegjin "Turgut Özal". Momentet e orës së leximit të librave, janë ato që nisin ditën e nxënësve tanë dhe kjo është mënyra më e mirë për ta nisur çdo ditë.

Librat që lexohen në këtë orar janë kryesisht tituj të autorëve klasikë, të sjellë të përshtatur për fëmijë, por edhe libra që nxënësit i përzgjedhin vetë.

Shpresojmë që kjo traditë të vazhdojë duke u pasuruar dhe me nismat e ndryshme, të cilat sjellin pranë nxënësve librin artistik me vlerat e tij.

Dieta e shëndetshme

Në kuadër të ndërgjegjësimi të nxënësve për një të ushqyer të shëndetshëm, në klasat e treta janë zhvilluar aktivitete të ndryshme mësimore në lëndën e diturisë së natyrës.

Pasi u njohën me piramidën ushqimore, nxënësit vlerësuan të ushqyerit e tyre.

Një dietë e duhur dhe e larmishme i ndihmon ata për të qenë të shëndetshëm. Nxënësit kishin sjellë në klasë fruta të ndryshme dhe diskutuan për vlerat dhe domosdoshmërinë e konsumimit të tyre. Një pjesë e rëndësishme e dietës është dhe konsumimi i ujit. Gjatë kësaj veprimtarie nxënësit u njohën dhe me ushqimet e pashëndetshme.



Kutia e Kujtimeve



Një orë tejet e veçantë mes kujtimeve të fëmijërisë...

Nxënësit e klasës së katërt zhvilluan në lëndën e historisë, veprimtarinë "Kutia e Kujtimeve". Secili prej nxënësve solli kutinë e tij, me një copëz nga jeta e tij, të mbushur me disa nga kujtimet më të veçanta nga fëmijëria.

Disa nga sendet e kutisë përfshinin rroba, lodra, libra si dhe foto.

Dita Kombëtare kundër Bullizmit

Dita Kombëtare kundër Bullizmit u organizua duke përfshirë nxënës, mësues, prindër dhe anëtarë të tjerë të komunitetit. Aktivitete të tjera në kuadër të kësaj dite ishin ekspozimi i punimeve të nxënësve me këtë tematikë në ambiente të ndryshme të shkollës.

U bë shfaqja e videove të ndryshme nëpër klasa, mesazhi i të cilave ishte: "Të luftojmë me të gjitha format e mënyrat këtë fenomen diskriminues dhe shkatërrues për botën e bukur të fëmijëve."

Aktivitete të tilla edukuese dhe që forcojnë frymën e bashkëpunimit, të respektimit, mirëkuptimit dhe të dashurisë për njëri-tjetrin, janë gjithmonë të dobishme dhe do vijnë edhe në vazhdim duke theksuar rëndësinë e luftës ndaj tij.



Mësojmë në klube duke u argëtuar dhe përmes praktikës



Klubet janë ndër aktivitetet më të dashura për nxënësit e shkollës sonë. Me fillimin e vitit shkollor, fillon dhe gjallërimi i tyre. Edhe këtë vit shkollor në kolegjin "Turgut Özal" kanë filluar aktivitetin e tyre disa klube. Në to marrin pjesë nxënës të klasave të ndryshme, që nga fillorja e deri në klasat e 9-vjeçares.

Klubet më të preferuara, ku nxënësit marrin pjesë janë ato të violinës, pianos, vizatimit, robotikës, gatimit etj. Ato realizohen pas mësimit dhe zhvillohen 2 herë në javë, deri në 45 minuta.

Klubi i violinës

Klubi i violinës prej vitesh zhvillohet në shkollën tonë. Violina, një nga instrumentet muzikore më të vështira, por edhe më të bukura, është nga instrumentet më të dashura për fëmijët. Kursi i violinës zhvillohet dy herë në javë, nga 50 minuta me nxënës të klasave 1-5. Secili nxënës mëson të luajë individualisht, por edhe në grup, duke u përgatitur kështu për koncertin që organizohet në fund të vitit shkollor.



Klubi i robotikës



Klubi i Robotikës mbetet ndër më të preferuarit për nxënësit e shkollës sonë. Ky klub synon përgatitjen e nxënësve për të marrë pjesë në olimpiadat ndërkombëtare të robotëve lego. Nxënësit e klasave të 6-ta, 7-ta dhe të 8-ta po punojnë për ndërtimin dhe programimin e disa robotëve, si: mBot, EV3, Ultimate 2.0 dhe versioneve të ndryshme të tij. Ata do të zhvillojnë ushtrime dhe programime me programim mBlock si dhe do të realizojnë lidhjen e robotëve me kompjuterin apo me sensorë të ndryshëm. Synimi i tyre është të marrin pjesë në disa prej olimpiadave më të rëndësishme ndërkombëtare.

Klubi i robotikës në shkollën fillore

Nxënësit e shkollës fillore vazhdojnë të marrin pjesë në klubin e robotikës. Nxënësit tanë mësojnë si të ndërtojnë robotë të formave të ndryshme dhe si t'i programojnë ata, të kryejnë lëvizje komplekse. Fëmijët do të prezantohen me pajisjen Microbit dhe do të angazhohen në programimin e saj. Gjithashtu, tematikë e klubit vazhdon të jetë programimi i lojërave të shumta në programin Scratch dhe ushtrimet zbavitëse e kreative me të.



Klubi i gatimit



Ai mund të quhet ndryshe dhe “Klubi i ëmbël”. Është fjala për Klubin e Gatimit, i cili është nga klubet më të dashura e më aktive në shkollën tonë. Nuk është hera e parë që shkruajmë për këtë klub. Për çdo të enjte, nxënësit mbledhen së bashku me mësuesen drejtuese në kuzhinën e tyre modeste, por aq të ngrohtë, dhe me pasionin që i karakterizon, përgatitin recetat e tyre “magjike” dhe shpërndajnë ëmbëlsi në gjithë shkollën.

Mësojmë përmes eksperimenteve në orën e kimisë

Për të gjithë nxënësit e shkollës sonë, praktika në laboratore për lëndët shkencore është krejt ndryshe nga një orë e zakonshme mësimi. Eksperimentet e ndryshme zënë vendin e shpjegimeve teorike të formulave e ligjeve dhe ushtrimeve e problemave. Këto na ndihmojnë jo vetëm për të kuptuar më mirë mësimin, por edhe për të nxitur bashkëpunimin dhe punën në grup.

Gjatë një ore pune laborator në lëndën e kimisë, u zhvilluan eksperimentet “Djegia e Kalciumit me anë të dritës” dhe “Krijimi i modelit të atomit”. Nxënësit i pushtoi kurioziteti për të praktikuar njohuritë. Por, eksperimentet janë sa interesante, e ndonjëherë edhe pak të rrezikshme për shkak të të papriturave që mund të ngjasin. Megjithatë, gjithçka në fund rezulton e këndshme dhe ajo që ka më tepër rëndësi, e vlefshme për të gjithë nxënësit. Një pamje krejt e veçantë shfaqet pas eksperimenteve, sepse në ambientet mjaft komode që ofron “Turgu Özal” ndihesh si një shkencëtar.



Mësojmë përmes eksperimenteve në orën e fizikës



Nxënësit e klasave të 6-ta dhe të 7-ta zhvilluan eksperimente në lëndën e fizikës për të konkretizuar temën “Matja e peshës”. Ata kanë matur peshën e sendeve të ndryshme me anë të dinamometrit. Në njërën anë ata vendosnin sendet e tyre të ndryshme si lapsa, goma etj dhe shihnin sa Njuton ishte secili përkatësisht. Me anë të këtyre matjeve, ora u bë mjaft interesante dhe konkrete për nxënësit.

Klasat e 9-ta kanë zhvilluar disa eksperimente gjatë orës së fizikës për të konkretizuar temën “Densiteti.” Fillimisht, ata matën masën e objekteve të ndryshme me peshore e më pas matën volumin me vizore për trupat e rregullt dhe me cilindër matës (epruvetë) për ata të çrregullt. Duke bërë vepimet e duhura, ata arritën të gjenin densitetin, duke e zhvilluar orën në një mënyrë ndryshe dhe duke i konkretizuar njohuritë e tyre për t’i përvetësuar më saktë ato.





Detektivët e vegjël zbulojnë përbërjen e dheut

Lënda e diturisë së natyrës i tërheq shumë vogëlushët kur ajo zhvillohet aty nga e merr emrin, në natyrë.

Nxënësit e klasës së 2D këtë herë vendosën të zbulojnë përbërjen e dheut.

Të pajisur me doreza dhe lupa zmadhuese, ata, si detektivë të vërtetë, fillimisht nisën të gërmonin në lulishtet e vogla rreth e qark shkollës dhe mblodhën një sasi të konsiderueshme të materialit që do të studionin.

Më pas, me lentet e tyre zmadhuese panë me kujdes kampionet e marra. Në to gjetën lloje të ndryshme gurësh, krimba, insekte të pajeta, copëza xhamash dhe u habitën kur panë me sytë e tyre se si ngjyra e dheut ndryshonte nga njëri vend te tjetri.

Në fund, i shkruan të gjitha zbulimet në fletoren e tyre të shënimeve.



Klasa e 3B në një projekt edukativ

“Të mësojmë rregullat”



Sjellja e bukur, të bën edhe më të bukur.

Shkolla jonë i ndihmon nxënësit që të mësojnë më shumë për sjelljen e duhur dhe të qenit qytetar dhe pjesë e komunitetit, duke zhvilluar shpesh veprimtari të ndryshme edukative dhe shoqërore. Për klasat e 3-ta këtë muaj u zhvillua një orë diskutimi për rregullat. Nxënësit u ndanë në grupe dhe secili prej grupeve duhej të bënte një listë të rregullave që duhet të ndjekë secili prej nesh në një ambient të caktuar, si në shkollë, në shtëpi, në lagje etj.

Vjeshta në klasat tona



Vjeshta është stina e ngjyrave, stina e frutave dhe e tapetit të artë që mbulon tokën. Fëmijët, këtë herë, menduan ta sjellin vjeshtën në klasat e tyre dhe për këtë shtruan dyshtemenë me gjethe, u ulën mbi to dhe diskutuan për ngjyrat, të mirat dhe bukuritë e kësaj stine.

Nxënësit e klasave të dyta bënë renditjen e fjalive të dhëna për këtë stinë.

Nxënësit e klasave të pesta shkruan për stinën e vjeshtës në prozë dhe poezi dhe i zbukuruan përshkrimet me vizatime sipas dëshirës. Në fund, të gjithë shijuan ëmbëlsinë e shegëve, hurmave, gështenjave, mollëve dhe frutave të tjera që ata kishin sjellë në klasë si një nga begatitë e vjeshtës.

Art me gjethe me klasën e 4D

Disa klasa i hapën dyert dhe e lanë vjeshtën t'i pushtonte me të gjitha ngjyrat e saj: të verdhën, të portokalltën, të kuqerremtën, etj, ndërsa nxënësit e klasës 4D bënë edhe më shumë se kaq. Ata nuk i shtruan gjethet në tokë, as nuk i hodhën si shi a flokë bore mbi kokat e tyre. Nxënësit e kësaj klase i përdorën gjethet për të treguar shpirtin e tyre artistik, ku dikush formoi një çadër apo një miush, një tjetër një peshk dhe dikush tjetër një elefant. Figurat që ata formuan ishin nga më të ndryshmet dhe punimet e tyre ishin të denja për një ekspozitë të vërtetë vjeshte.





Koha për shkencë - eksperimente me klasat 3, 4, 5

nga mësuese Rezana

Shkenca është e bukur, mjafton të dish t'ua tregosh nxënësve këtë anë të mrekullueshme të saj.

Këtë vit nxënësit e klasave të treta, të katërta dhe të pesta zhvillojnë një orë në javë eksperimente të ndryshme shkencore në laboratorët përkatës të paralelit të tyre. Ata presin me padurim se me çfarë eksperimenti do i surprizojë mësuese Rezana çdo javë në orën e saj. Me sytë plot kureshtje ndjekin çdo lëvizje dhe shpesh habia i pushton fytyrat e tyre. Por ora bëhet më e bukur në vazhdim, kur janë ata vetë që do provojnë të zhysin vezët njëherësh në gotë, të trazojnë përzierjen që ndryshon ngjyrë nga njëra epruvetë në tjetrën, të provojnë tingujt që dalin nga materialet e ndryshme etj. Në këtë orë, duke përdorur mjetet e ndryshme laboratorike fëmijët ndihen vërtet shkencëtarë të vegjël.



Ripërdorim - Reduktim - Riciklim

me klasat e dyta



A e mendojmë ndonjëherë se sa shumë konsumojmë gjatë një viti? Dhe jo vetëm ushqime! Sa veshje, lodra, pajisje shtëpiake, mjete shkollore na dalin të tepërta apo i lëmë mënjane se nuk na pëlqejnë më? Nëse gjithmonë vetëm blejmë të reja, çfarë i sjellim tokës?

Pyetje të tilla ngritën nxënësit e klasave të dyta në bisedat që u zhvilluan me ta për ripërdorimin-reduktimin dhe riciklimin e mjeteve të ndryshme.

Ishin vetë ata që hodhën idenë e ripërdorimit të kartonave edhe nga ana tjetër e tyre, përdorimin e lapsave të vegjël për punime në orën e artit pamor, për dhurimin e veshjeve dhe librave të fëmijëve që jetojnë në familje me vështirësi ekonomike etj. Ata theksuan se vetëm duke ripërdorur dhe duke ricikluar ne mund ta shpëtojmë shtëpinë tonë të madhe, Tokën.

Teatri i shkollës "Gjiganti prej akulli" me klasat e katërta



Klasa e Dramës në shkollën tonë, pothuajse nuk e njihet qetësinë në asnjë orë të javës. Këtë herë ishin nxënësit e klasave të katërta ata që i shfrytëzuan në maksimum ambientet e kësaj klase për të vënë në skenë pjesën "Gjiganti prej akulli".

Të gjithë nxënësit morën pjesë dhe interpretuan bukur rolin e caktuar. Në fund ishte e vështirë të caktoje se cili prej tyre ishte aktori apo aktoria më e mirë.

Festojmë Vitin e Ri - klasat e katërta

Festa e Vitit të Ri është nga më të shumëpriturat nga të gjithë fëmijët. Ngjyrat, drita, zbukurimet dhe, padyshim, dhuratat e bëjnë këtë festë mjaft të dëshiruar nga vogëlushët. Nxënësve të klasës 4D ua shtoi gëzimin surpriza e përgatitur nga prindërit e shoqes së tyre të klasës, Dea Bimbashi.

Për secilin nxënësi ishin përgatitur dhurata të veçanta, të paketuara bukur dhe me nga një shënim të personalizuar. Lumturia e fëmijëve shihej në sytë dhe buzëqeshjet e tyre, si dhe në mënyrën se si luajtën me lodrat e zgjedhura me aq kujdes për moshën e tyre.



Projekt - Qyteti im



Tremujori i parë në Anglisht Speaking për klasat e pesta, me mësuese Elissa Lewis, u mbyll me një projekt në grup mbi të ardhmen e qyteteve. Përgjatë tri javëve nxënësit diskutuan, si mbi përparimin dhe teknologjinë e re në zhvillimin urban, ashtu dhe për problemet me të cilat përballen në qytetin ku jetojnë apo në qytetet e tjera të botës. Pas diskutimit intensiv, nxënësit dizenuan dhe ndërtuan qytetin e dëshiruar, si dhe prezantuan idetë e tyre për një qytet të së ardhmes, i cili të jetë i qëndrueshëm, eko-miqësor dhe pa vështirësitë që ata hasin aktualisht në qytetin e tyre.

Disa nga nxënësit propozuan robotë për të mbajtur rrugët të pastra nga mbeturinat dhe papastërtitë, të tjerët zhvilluan sisteme parkimi dhe menaxhimi të trafikut, dhe disa të tjerë i larguan fare makinat nga qyteti i tyre (një qytet pa makina).

Nxënësit përfituan nga ky projekt një koncept të ri se si mund të duken hapësirat e tyre të ardhshme të jetesës. Disa prej tyre, madje, janë frymëzuar që një ditë këto ide t'i kthejnë në realitet.

Ushqime të shëndetshme dhe të pashëndetshme - klasat e treta



Ushqimi është jetik, por po kaq e rëndësishme është edhe mënyra se si ushqehemi. Midis ushqimit të shpejtë që na shijon dhe ushqimit të shëndetshëm për organizmin tonë, gjithmonë duhet të këmbëngulim te recetat e gatuar në shtëpi, të bëra me dashuri nga nënat dhe gjyshet tona duararta, të këmbëngulim te ushqimet e shëndetshme. Gjithashtu, duhet t'u japim hapësirën e duhur frutave të freskëta të stinës dhe perimeve plot vitamina.

Ushqimet e tjera të përpiqemi t'i konsumojmë sa më rrallë dhe për këtë, nxënësit e klasave të treta, do t'i kujtojë shpesh edhe piramida ushqimore që sapo e mësuan në shkollë.



Në Panairin e Librit



“Një fëmijë që lexon, do të jetë një i rritur që mendon...”
 Panairi i 22-të i Librit, Tirana 2019, u vizitua dhe nga nxënësit e kolegjit “Turgut Özal”.
 Ky Panair është ngjarja më e madhe kulturore në pasqyrimin e veprimtarisë letrare brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë, i cili jep mundësinë për të gjetur në të njëjtin vend, atë që çdo lexues dëshiron.
 Ku ka më bukur se të jesh adhurues i librave dhe ta gjesh veten midis tyre, “në një botë me libra”.
 Sheh, shfleton, zgjedh librin tënd, takon autorin, përkthyesin, botuesin, pasi libri mbetet pasuri që nuk i humbet vlera kurrë!

Momente plot gëzim me fëmijët e klasave të para në Pezë



Balonat shumëngjyrëshe, tërheqje me litar, gara me vrapime e lojëra me stafeta, të cilat shoqërohesin me gëzimin dhe të qeshurat e fëmijëve.

Këto ditë të ngrohta, të bukura e plot diell të fundit të vjeshtës, nuk mund të kalohen më këndshëm, sesa jashtë në natyrë. Dhe ishin pikërisht nxënësit e klasave të para, të cilët zhvilluan ekskursionin me temë "Vjeshta" në Pezë. Qëllimi i tij ishte që fëmijët të shihnin dhe të shijonin kalimin nga një stinë në një tjetër, vrojtimi i ndryshimeve që sjell stina e vjeshtës në natyrë, por edhe argëtimi mes bukurisë dhe ajrit të pastër.

Momente të këndshme në shoqërinë e njëri-tjetrit



Nxënësit e klasës së 6D, e cila fitoi Panairin Ushqimor dhe nxënësit e klasës së 6G që fituan kampionatin, gëzimin e këtyre arritjeve, menduan t'i ndanin me njëri-tjetrin jashtë mjedisit të shkollës, si një aktivitet jashtëshkollor.

Disa ditë pas Panairit, zgjodhën të argëtoheshin në dy qendrat më të përshtatshme për fëmijë: "Latitude" dhe "Ring". Argëtimet dhe emocionet e provuara gjatë këtij aktiviteti lidheshin me dy arsye: qetësinë e plotësinë që ndienin se kishin lumturuar fëmijë dhe familje në nevojë, por njëkohësisht ndiheshin të lumtur të ndanin kohë dhe emocione me shoku-shokun.

"Të gjithë jemi të barabartë dhe, si të tillë, le të motivojmë çdokënd për të krijuar një shoqëri me nevoja dhe dëshira të plotësuara, sepse bamirësia shpërblen!"

Në kinema me klasën e 2G



Projekt me klasat e treta

"Të drejtat e fëmijëve"

"Të drejtat e fëmijëve", projekt ndërlëndor që u zhvillua me nxënësit e klasave të treta dhe la shumë mbresa te nxënësit për mënyrën se si u trajtua, brendinë e tij dhe bashkëpunimin që patën nxënësit me njëri-tjetrin.

Gjatë prezantimit të këtij projekti, nxënësit gjithashtu dhe i drejtuan pyetje njëri-tjetrit, duke mësuar kështu më shumë për të drejtat e tyre, bazuar në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve. Grupet e prezantuan punën e tyre në sallën e teatrit dhe mbyllja ishte me këngën "Po të qeshin të gjithë fëmijët".



Kinemaja, vendi ku realiteti bashkohet me ëndrrat. Aty ku ëndrrat të marrin e të futin në një botë të madhe, të bukur e plot imagjinatë.

Ishte klasa e 2G, e cila shijoi ndër të parat për këtë vit shkollor, kënaqësinë që të sjell kinemaja. Nxënësit shkuan në kinema "Cineplexx", ku panë një film shumë të bukur për moshën e tyre të titulluar "Abominable".

Ky film ishte mbi të gjitha një film me vlera edukative, i cili u përcillte fëmijëve dashurinë, ngrohtësinë, rëndësinë dhe vlerat që familja ka për secilin prej nesh.



Djemtë e klasave të 7-ta ekskursion në Llogora



Djemtë e klasave të 7-ta organizuan një ekskursion në Parkun Kombëtar të Llogorasë. Gjatë rrugës nxënësit ndaluan për të vizituar vende të tilla si Vlora apo Laguna e Nartës, për t'u ndalur në Llogora në "Pishën Flamur". Nxënësit ia kaluan shumë bukur. Ishte vërtet një udhëtim që do t'u mbetet për një kohë të gjatë në mendje.



Në Llogora me vajzat e klasave të 7-ta e të 8-ta

Një fundjavë e këndshme për vajzat e klasave të 7-ta dhe të 8-ta mbi kurorën e gjelbër të drurëve halorë në Llogora. Gjatë rrugës pati ndalesa për të vizituar vende të veçanta, si: Laguna e Nartës, Pedonalja në Vlorë dhe Qafa e Llogorasë. Pushueset tona e sfiduan lodhjen dhe kaluan një natë plot argëtim mes lojërave të ndryshme, frekuencimit të pishinës dhe bisedave të ëmbla në rrethin e tyre shoqëror.

Klasat e 6-ta në Shkodër

Hijerëndë, e bukur dhe bujare, si një zonjë e vërtetë shtëpie, Kalaja hapi portat e saj për nxënësit e klasave të 6-ta të shkollës sonë, në këto ditë të ngrohta të pranverës. E ndërtuar në rrëzë të qytetit të Shkodrës, është ajo e para që i uron mirëseardhjen dhe mirëpret çdo vizitor në qytet. Duket se ruan në muret e saj një krenari që nuk e mposht koha. Ecim përmes oborreve të saj dhe ngjitemi në Bedenat e Kalasë, nga ku shfaqet para syve tanë me gjithë madhështinë e tij, qyteti i bukur i Shkodrës. Duket mahnitës nga lartësia e Kalasë, me qetësinë, pozitivitetin dhe humorin e mirë që karakterizon njerëzit e tij. Bashkohen tejposhtë nën ngjyrën e bruztë, qielli, deti, liqeni dhe lumenjtë dhe vizitori mbetet i mahnitur. Hyn brenda në Muze dhe historia shfaqet e gjallë para teje. Nuk mjaftojnë orët për të shijuar gjithë bukurinë e hijeshinë në këtë vend.

.... Dhe më pas, një drekë plot shije, e cila mbyll këtë vizitë mes Bukurisë, Mikpritjes dhe Bujarisë shkodrane.



Shëtitje në Sarandë me klasat e 4-ta dhe të 5-ta

Muaji nëntor për nxënësit e klasave të katërta dhe të pesta u shoqërua me veprimtari jashtëshkollore në jug të vendit. Vizita e parë ishte në Kalanë e Gjirokastrës. Nxënësit u njohën me Luftën e Mashkullores me në krye Çerçiz Topullin. Në bustin e tij u bënë edhe foto. U njohën me vlerat historike të kalasë si dhe historinë e Argjirosë.

Më pas udhëtimi vazhdoi drej qytetit të bukur bregdetar të Sarandës. Edhe pse ishte nëntor, natyra kishte rezervuar për nxënësit një kohë të mrekullueshme. U vizitua kalaja e qytetit dhe më pas Butrinti. Vizita në Butrint u shoqërua edhe me ciceron.

Ksamili ishte ndalesa ku nxënësit u akomoduan për fjetje. I veçantë ishte zgjimi i mëngjesit, rrezet e diellit, pamja madhështore e detit dhe mëngjesi i shijshëm në hotel, që të bënin të mos largoheshë nga ky vend i mrekullueshëm.



AKTIVITETE SPORTIVE

Kampionati i Basketbollit për klasat e 8-ta dhe të 9-ta

Aktivitetet sportive janë nga më të dashurat për nxënësit e shkollës sonë. Në to gërshetohen dukshëm taktikat dhe aftësia që kanë nxënësit tanë në sporte të ndryshme, bukuria e entuziazmi i lojës, si dhe dëshira për fitore. Energji, lojë e bukur, emocione!

Kampionati i Basketbollit për klasat e 8-ta dhe të 9-ta, përfundoi mes ndeshjesh të forta e plot emocion, si për vajzat dhe për djemtë.

Për klasat e 8-ta për vajzat fituese doli klasa e 8E, për djemtë klasa e 8G.

Për klasat e 9-ta për vajzat fituese doli klasa e 9A, për djemtë klasa e 9C.





Kampionati i Basketbollit për vajza, klasat e 6-ta dhe të 7-ta

Ka përfunduar Kampionati i Basketbollit për klasat e gjashta. Në finalen e klasave të 6-ta u ndeshën ekipet e klasave 6A – 6G. Ndeshja u finalizua me fitoren e klasës së 6G.

Në finalen e klasave të 7-ta u ndeshën ekipet e klasave të 7E – 7G.

Fituese doli klasa 7G. Në të dyja ndeshjet loja ishte e fortë dhe konkurruese.

Atmosfera e ndezur përreth fushës u shtoi edhe më shumë dëshirën për të luajtur bukur skuadrave përfaqësuese.



Kampionati i Futbollit për klasat e 6-ta dhe të 7-ta

Kampionati i Futbollit është nga kampionatet më të dashura, më emocionuese dhe të mezipitura për nxënësit. Ky kampionat ngre peshë gjithë nxënësit e klasës dhe jo vetëm lojtarët në fushë.

Për klasat e 6-ta në finalen e këtij kampionati kanë dalë klasat e 6G-6F, klasa fituese ishte klasa e 6F.

Për klasat e 7-ta në finalen e këtij kampionati kanë dalë klasat e 7B - 7C, klasa fituese ishte klasa e 7C.

Ndeshjet e zhvilluara kanë qenë plot emocion dhe nuk kanë munguar dhe "tifozët" e mbështetësit për çdo skuadër.

Dorëzoni këtë KUPON në
çdo dyqan Sport Vision
dhe PËRFITONI

**20%
ULJE**

"Koleksioni i Ri SS2020"

TEG, QUT, TOPTAN, SHKODËR,
DURRËS, FIER, VLORË, KORÇË



Sport Vision Albania



sportvisionalbania



www.sportvision.al

Dorëzoni këtë KUPON në
në Nike Shop në TEG
dhe PËRFITONI

**15%
ULJE**

"Koleksioni i Ri SS2020"



Nike Shop TEG

Dorëzoni këtë KUPON
në BUZZ në QUT
dhe PËRFITONI

**20%
ULJE**

"Koleksioni i Ri SS2020"



Buzz Sneaker Station Albania



buzzsneakerstation

Dorëzoni këtë KUPON në
çdo dyqan Sport Reality
dhe PËRFITONI

**20%
ULJE**

"Koleksioni i Ri SS2020"

QUT, FIER, VLORË, SHKODËR, LEZHË

**SR | SPORT
REALITY**



adidas

Reebok

ellesse



Slazenger

ATHLETIC

COCOMO

lotto

NAVIGARE



Sport Reality Albania



sportrealityalbania

Mirë se vini të dashur vogëlushë!

Hareja, gjallëria dhe gëzimi u rikthyen në datën 2 shtator, në ambientet e kolegjit "Turgut Özal". Pas stinës së verës, erdhi sërish pranvera me lulet e saj më të bukura, vogëlushët e grupeve të para, të dyta dhe të parashkollorit.

Zërat e tyre si cicërima zogjsh dëgjoheshin anekënd shkollës e ambienteve të kopshtit.

Buzëqeshja, zbavitja dhe mësimi përmes lodrimit do t'i shoqërojnë gjatë këtij viti shkollor.

U urojmë shumë suksese vogëlushëve!

Mirë se vini të dashur fëmijë mes zbukurimeve, lodrave dhe urimeve pafund.

Është koha juaj për të hapur krahët dhe për të fluturuar!



"Pema e miqësisë"

"Sa e bukur është pema e jonë, e cila tregon për të gjithë shokët e shoqet e mia." Kështu shprehen vogëlushët e grupeve të para për pemën e tyre të miqësisë.

"Pema e miqësisë" është momenti i parë me shokët e shoqet, momenti kur fëmijët fillojnë të mburren për shoqërinë e tyre. Me dashuri secili prej tyre vuri emrin e tij, ku i dihet, ndoshta një ditë do t'ua kujtojnë se kanë qenë bashkë në kopsht, kur kanë qenë 3 vjeç. Ne po përpiqemi t'u përcjellim fëmijëve vlerat e miqësisë së vërtetë dhe dashurisë për njëri-tjetrin.

Ekskursioni në Kopshtin Botanik

Grupet e para të kopshtit, organizuan një ekskursion te Kopshti Botanik për të parë më nga afër natyrën në stinë e vjeshtës. Fëmijët, të gëzuar, vraponin duke kapur gjethet shumëngjyrëshe që kishin rënë përtokë. U mahnitën nga llojshmëria e ngjyrave të gjetheve dhe zbuluan sekretin se përse vjeshta quhet “e artë”. Kënaqësia e kësaj dite ishte shumë e madhe dhe natyra me shumë bujari u ofroi hapësirën që ata donin për të organizuar lojëra të shumta. Këto momente me njëri - tjetrin dhe natyrën, janë nga momentet më të gëzuara për vogëlushët.



“Format gjeometrike i gjejmë kudo”

Për të kuptuar sa më mirë temën ditore “Format gjeometrike i gjejmë kudo” dhe për t’u zbavitur e mësuar përmes praktikës, vogëlushët e kopshtit nëpërmjet një projekti të formuar me mjete të riciklueshme, ndërtuan një qytet me forma gjeometrike.

Fëmijët kuptojnë përmes këtij aktiviteti argëtues se format gjeometrike i gjejmë kudo. Si në një qytet të vërtetë ata emërtuan dhe dalluan objektet, të cilat i shikojnë në mjedis, si: çatitë e shtëpive, vijat e rrugës, pallatet, semaforin etj. Dhe treguan se cilës formë gjeometrike i ngjan secila prej tyre.

Në përfundim të kësaj ore mësimi fëmijët u njohën me format gjeometrike, rrethorin, katrorin, trekëndorin, drejtkëndorin, por dhe u argëtuan gjithashtu.



“Mirupafshim zogj shtegtarë”

Ndër nga aktivitetet më zbavitëse për vogëlushët e kopshtit, janë aplikacionet e ndryshme përmes të cilave ata mësojnë shumë njohuri të reja.

Një ndër aplikacionet, i cili u pëlqeu shumë fëmijëve ishte aplikacioni me figura, ngjyrosje dhe në formë loje, me temë: “Mirupafshim zogj shtegtarë”.

Fëmijët njihen me zogjtë që shtegtojnë, mënyrën se si zogjtë shtegtojnë dhe asyen përse ata largohen nga një vend në një vend tjetër.

Nëpërmjet këtij aplikacioni fëmijët arrijnë të njohin nga afër dhe imazhin e zogjve që shtegtojnë. Këtë herë ishte dallëndyshja, ajo me të cilën u njohën fëmijët.

“Mirupafshim zogj shtegtarë, shihemi përsëri në pranverë!”



Vizitë tek “Dentisti”

Vogëlushët e kopshtit të grupit të dytë “Borëbardha”, temën e mësimi “Kujdesimi për dhëmbët” e zhvilluan në një mënyrë shumë interesante. Me ftesë të prindit të shokut të tyre Loren Demaj, fëmijët vizituan së bashku me edukatoren një klinikë dentare, për të parë më nga afër se si rregullohen dhëmbët. Ata dëgjuan me vëmendje këshillat që iu tha dentisti, kujdesi që duhet të tregojnë për dhëmbët dhe sa herë duhet larë dhëmbët, si dhe u tregoi për ushqimet që duhet të konsumojnë për mosprishjen e tyre. Në fund fëmijët morën dhuratë nga një furçë dhëmbësh shumë të bukur që u pëlqeu shumë.



Argëtohemi dhe shijojmë frutat symbyllazi

Krahas vlerave ushqyese që kanë frutat, ne së bashku me vogëlushët tanë, fëmijët e grupit III, zbavitemi duke provuar shijet e frutave dhe duke u zbavitur, njëkohësisht. Ora e lojës, me temë "Frutat" u zhvillua në klasë, ku në ndryshim nga orët e tjera ishte e pranishme një shportë plot me fruta të të gjitha llojeve. Për zhvillimin e lojës u përdor një shall, me të cilin u mbylleshin sytë fëmijëve dhe më pas shokët i afronin njëri-tjetrit një frut për ta ngrënë dhe shijuar. Pa hapur sytë, ata tregonin emrin e frutit dhe përshkruanin shijen që kishte për ta (e ëmbël, e thartë etj). Loja zbavitëse u mundësoi nxënësve jo vetëm argëtim dhe shijim, por mësuam emrat e frutave, si dhe të përshkruanin shijen që ato linin. Një gjë është e sigurtë: Shija e frutave dhe e lojës la mbresa dhe kënaqësi te të gjithë fëmijët.



Vizitë në ekspozitën e shkollës

Me afrimin e Festave të 28 dhe 29 Nëntorit në ambientet e shkollës sonë u hap ekspozita me fotografi, piktura, objekte historike dhe simbole kombëtare, të cilat u sollën nga vetë nxënësit, objekte të cilat janë pjesë e trashëgimisë së tyre familjare. Ndër vizitorët më të vegjël të kësaj ekspozite ishin dhe fëmijët e kopshtit, të cilët shprehën një kuriozitet të madh për këto objekte. Fëmijët u kënaqën dhe mësuam shumë gjatë vizitës në këtë ekspozitë.



Mësojmë historinë tonë përmes aplikacionit të Flamurit

Përcjellja e vlerave tona kombëtare brezave, është detyrë e secilit prej nesh dhe simboli i flamurit është simboli i kombit. Projekti i realizuar për Festat e 28-29 Nëntorit nga fëmijët e kopshtit ishte aplikacioni i Flamurit. Fëmijët u ndanë në grupe dhe me kartona e me letra krep me ngjyra arritën të realizonin flamurin. Fëmijët u ndjenë shumë krenarë për punën e tyre. Ata edhe pse të vegjël realizuan një projekt madhështor!



"Cikli i jetës së fluturës"

Një ndër projektet më të bukura dhe i cili u pëlqeu shumë fëmijëve të parashkollorit, ishte projekti "Cikli i jetës së fluturës". Fëmijët panë në fillim në smartboard sesi formohet flutura, për ta pasur më të qartë projektin. Pasi panë videon, fëmijët me ndihmën e mësueses morën materialet, si: makarona, fije peri, ngjitës, ngjyra, kartona etj., me të cilat krijuan projektin. Element i rëndësishëm dhe e veçanta e këtij projekti, ishte se cikli jetësor i fluturës u ndërtua mbi gjethe.



Në klasën e artit

Pas mësimit të shkronjës “l” i vogëlushët e grupit “Fluturat” bënë një aktivitet mjaft zbavitës në klasën e Artit. Ata ndërtuan iriqin me plastelinë, me patate dhe kunjë dhëmbësh. Në fund të kësaj ore të këndshme, fëmijët bënë foto me iriqin e tyre dhe tregonin se cili prej iriqëve ishte më i bukur.



Aplikacioni “Pylli me çadra të çuditshme”

Në kopshtin tonë fëmijët mësojnë, argëtohen, luajnë duke nxitur imagjinatën. Duke qenë se kjo javë fillon me mësimin e shkronjës “Ç”, fëmijët tregojnë sende dhe objekte që fillojnë me shkronjën “Ç”. Një nga këto sende është “Çadra”. Fëmijët flasin për rëndësinë e çadrës dhe llojet e saj. Më pas fëmijët ushtrohen të bëjnë punime të ndryshme zbavitëse, si: arti i ngjyrosjes së çadrave të dimrit, aplikacionin “Çadra e diellit” dhe deri tek “Çadrat e çuditshme”, në të cilat fëmijët përmes imagjinatës, krijojnë çadrën e tyre të çuditshme me vizatimet e tyre të përforuara. Në fund të orës fëmijët krijuan aplikacionin “Pylli me çadra të çuditshme”. Kjo temë mësimore u mësoi vogëlushëve shumë gjëra të bukura dhe i zbaviti pa fund.

Argëtohemi me çadrat në natyrë

“Argëtohemi dhe mësojmë si të mbrohemi në një ditë me shi, madje dhe si të kënaqemi.”, ky ishte qëllimi i lojës argëtuese me çadra, me fëmijët e parashkollorit. Fëmijët me çadrat e tyre imagjinuan sikur po binte shi dhe ata rrinin nën çadër. Fëmijët shprehën emocionet dhe reagimet e tyre si në një ditë të vërtetë me shi. Madje ata dhe vallëzuan “Vals në shi”. Kjo ishte një ditë, e cila i zbaviti shumë vogëlushët.



Në tapetin vjeshtor

Stina e vjeshtës i gjeti vogëlushët tanë të ulur në tapetin e bukur të gjetheve e ngjyrave të saj. Vogëlushët të mahnitur nga ngjyrat e saj, e shtruan ambientin e klasave me gjethe dhe të ulur mbi to biseduan me edukatorët për veçoritë e stinës së vjeshtës. Gjithashtu ata jo vetëm mësuan për këtë stinë, por dhe u zbavitën me lojëra të ndryshme mbi tapetin vjeshtor.



Teatri i kukullave

grupi i parë dhe i dytë

Në kuadër të aktiviteteve jashtëshkollore, fëmijët e grupeve të para dhe të dyta shkuan në teatrin e kukullave për të parë shfaqjen “Tre derrkucët”. Është një përrallë e pëlqyer nga të gjithë fëmijët. Ata ndoqën me vëmendje dramatizimin e personazheve, ku ndër to dalluan materialet që përdorën për ndërtimin e shtëpive të tyre tre derrkucët, si dhe tingujt dhe rolet e personazheve. Mesazhi i përrallës ishte i qartë për të gjithë fëmijët. Ata e shprehën kënaqësinë që ndienin gjatë shfaqjes me të qeshura dhe duartrokitje të shpeshta.



Dhëmbi i sëmurë


Mësojmë përmes lojës dhe praktikës duke u zbavitur është nga veprimtaritë më të dashura e të gëzueshme për fëmijët. Mësimi i rregullave se si të kujdesen për dhëmbët e tyre me temën “Dhëmbi i sëmurë”, i tërhoqi shumë vogëlushët e parashkollorit. Njëri prej fëmijëve mori rolin e dentistit. Më pas, përmes mësim-it-lojë, ata improvizuan një vizitë të vërtetë te dentisti. Dalluan ushqimet e shëndetshme dhe ushqimet që prishin dhëmbët, morën këshilla se si të kujdesen për to. Dhe në fund vogëlushët praktikuan larjen e dhëmbëve, gjë e cila i kënaqi shumë.





SHOQËRI AGJENTËSH NË SIGURIME

📞 067 20 26 650



antigonaterthorja@gmail.com



Blloku Vasil Shanto



Rruga Brigada vlll Tiranë

Dorëzoni këtë KUPON dhe PËRFITONI deri në

20%
ULJE

📞 067 20 26 650

FALEMINDERIT

Së bashku jemi
më të fortë



Robotics

Learn

Design

Program

Perform

